




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

DRAFT-RAPORT MONITORIMI JANAR – QERSHOR 2025

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË PËR TË MITUR 2022-2026

www.drejtesia.gov.al

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTIME.....	3
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
II. REALIZIMI I QËLLIMEVE TË POLITIKËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2024.....	8
III. METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE PERFORMANCËS	10
➤ Koordinimi institucional për hartimin e raportit të monitorimit dhe performancës	10
➤ Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës	11
➤ Fazat e ndjekura për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës.....	11
➤ Metodologjia e analizimit të të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës	12
➤ Konsultimi publik i raportit të monitorimit dhe performancës.....	12
IV. VLERËSIMI I ARRITJES SË QËLLIMEVE TË POLITIKËS KUNDREJT MASAVE DHE AKTIVITETEVE	18
V. NIVELI I REALIZIMIT NË TOTAL PËR 64 MASA NË PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2024.....	33
VI. VLERËSIMI I SFIDAVE, HAPAT NË VIJIM	34

SHKURTIME

AKCESK	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMA	Autoriteti Mediave Audiovizive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore
AP	Avokati i Popullit
AS	Akademia e Sigurisë
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
BE	Bashkimi Evropian
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DM	Drejtësia për të Mitur
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
DHASH	Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
INSTAT	Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë
IDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur



KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KL GjJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHRF	Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PR	Parlamenti Rinor
SDM 2022-2026	Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2022-2026
SIDhDPM	Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur
QPKMR	Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve
RSH	Republika e Shqipërisë
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
TdH	Terre des Homes
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijet
UP	Urdhri i Psikologut
UPS	Urdhri i Punonjësit Social

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Legjislacioni shqiptar bazohet në parimet e drejtësisë miqësore për fëmijët, e cila ka në thelb të saj garantimin e respektit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjithë të drejtave të fëmijëve, në nivelin më maksimal të mundshëm. Kuadri ligjor synon të garantojë elementët e domosdoshëm të drejtësisë miqësore të tillë si: aksesueshmëria, përshtatshmëria, efektiviteti në raport të drejtë me nevojat dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Parime të tilla si pjesëmarrja dhe informimi, interesi më i lartë i fëmijës, dinjiteti, mbrojtja nga diskriminimi, shteti i së drejtës, qëndrojnë në themel të kuadrit ligjor shqiptar. Drejtësia miqësore përfshin të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare si dhe të integritetit dhe dinjitetit.


Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026 dhe Plan i saj i Veprimit është strategjia e dytë në fushën e drejtësisë për të mitur. Dokumentet e saj strategjike përfshirë si, Plan i Veprimit dhe Pasaporta e Indikatorëve, u miratuan në me VKM Nr. 892, datë 27.12.2022 dhe zbatimi i saj nisi menjëherë.

Zbatimi i “SDM 2022-2026” është arritur përmes një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për të verifikuar progresin në plotësimin ose jo të objektivave specifike dhe masave të vendosura në Planin e Veprimit.

Rrjeti Ndërinstitucional në nivel qendror për zbatimin e strategjisë është grupi ku diskutohen çështje të ecurisë së zbatimit të objektivave dhe masave të “SDM 2022-2026” me qëllim bashkëpunimin ndërinstitucional me grupet e interesit. Rrjeti Ndërinstitucional në nivel qendror, drejtohet nga Ministria e Drejtësisë dhe ka në përbërje të tij përfaqësues nga institucionet e tjera ligjzbatuese, që janë përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e treguesve në kompetencën e tyre. Ky rrjet mbështetet në veprimtarinë e tij nga Sekretariati Teknik (ST), i cili do të drejtohet nga Ministria e Drejtësisë.

SDM 2022-2026 parashikon për zbatim gjatë 5 viteve të implementimit të saj, 4 Qëllime Politike, 13 Objektiva Specifike dhe 64 masa për të kontribuar në performancën e 45 indikatorëve cilësorë dhe sasiorë.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Parë Politik për “Parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fëmijëve” konstatohet se:




Janë ndërmarrë veprime të qëndrueshme për të promovuar edukimin ligjor, ndërgjegjësimin dhe mbrojtjen e fëmijëve. Programet mësimore kanë ndihmuar në forcimin e kulturës qytetare dhe sjellore, ku mësuesit kujdestarë dhe psikologët kanë luajtur rol parandalues ndaj dhunës dhe bullizmit. Në shumë shkolla janë realizuar anketa me nxënës dhe prindër për të vlerësuar efektivitetin e programeve dhe mënyrën e trajtimit të temave që lidhen me sjelljet e rrezikshme dhe përgjegjësitë ligjore të të miturve. Oficerët e sigurisë kanë zhvilluar takime periodike ndërgjegjëse me nxënës për parandalimin e dhunës, përdorimit të drogave dhe përfshirjes në sjellje deviante.

Në nivel komunitar, janë realizuar fushata informuese dhe aktivitete ndërgjegjëse për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe përfshirjes së fëmijëve në vepra penale. Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve kanë bashkëpunuar me strukturat arsimore, policinë dhe organizatat lokale për menaxhimin dhe referimin e rasteve në rrezik. Gjithashtu, janë zhvilluar aktivitete për sigurinë online, edukimin mediatik dhe mbrojtjen e privatësisë së fëmijëve, duke ndihmuar në krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe gjithëpërfshirës për zhvillimin e tyre.

Në përmbledhje, ndërhyrjet e ndërmarra gjatë kësaj periudhe kanë konsoliduar qasjen parandaluese dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, duke ndikuar ndjeshëm në rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga çdo formë dhune apo sjellje që cenon të drejtat e tyre.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Dytë Politik “Një kuadër ligjor, institucional dhe me profesionistë që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë” konstatohet se:

23 masa të zbatueshme për janar qershor 2025




■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara ■ Të zbatuara

Gjatë periudhës raportuese janë ndërmarrë hapa të qëndrueshëm për forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe për rritjen e kapaciteteve profesionale të aktorëve që punojnë me fëmijët në sistemin e drejtësisë. Janë miratuar dhe zbatuar akte nënligjore që përmirësojnë procedurat përmbartimore dhe ekzekutimin e vendimeve që përfshijnë fëmijë, me fokus çështjet e kujdestarisë, të drejtës së takimit dhe detyrimeve ushqimore. Paralelisht, janë ndërmarrë masa për rritjen e transparencës dhe monitorimit të veprimeve përmbartimore, duke siguruar respektimin e interesit më të lartë të fëmijës në çdo fazë të procesit.

Është vënë në zbatim një qasje më e integruar për përmirësimin e aftësive profesionale të punonjësve në fushën e drejtësisë për të mitur, përmes trajnimeve tematike, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shkëmbimit të praktikave. Gjithashtu, është përmirësuar procesi i mbledhjes dhe analizimit të të dhënave statistikore për çështjet që përfshijnë fëmijë, duke mundësuar një monitorim më të saktë të trendeve dhe nevojave për ndërhyrje. Këto zhvillime reflektojnë progres të qëndrueshëm drejt një sistemi më funksional dhe të specializuar të drejtësisë miqësore për çdo fëmijë.

Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Tretë Politik “Garantimin e qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë” konstatohet se:




Progres i dukshëm drejt krijimit të një sistemi funksional dhe të aksesueshëm për fëmijët si përfitues të drejtëpërdrejtë të shërbimeve të drejtësisë. Është konsoliduar rrjeti i ndihmës juridike falas përmes

Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, bashkëpunimit me organizata jofitimprurëse dhe klinika ligji, si dhe kontraktimit të avokatëve të specializuar për mbrojtjen e të miturve, duke siguruar ofrim më profesional dhe më të shpejtë të shërbimeve. Janë forcuar mekanizmat e informimit dhe ndërgjegjësimit të fëmijëve dhe familjeve të tyre, përfshirë materialet e thjeshtëzuara, fletëpalosjet, videot informuese, Buletinin mujor, Linjën e Gjelbër 08001010 dhe platformën “Juristi online”, si mjete praktike që u mundësojnë fëmijëve marrjen e informacionit dhe mbrojtjes ligjore në mënyrë miqësore, të kuptueshme dhe pa kosto.

Paralelisht, është avancuar drejt specializimit të mëtejshëm institucional: janë ndërmarrë masa për sigurimin e gjyqtarëve, prokurorëve, punonjësve të policisë, shërbimit të provës dhe përmbaruesve të trajnuar për të mitur; janë forcuar standardet për mjedise dhe procedura miqësore për fëmijët, përfshirë përdorimin e intervistimit të specializuar dhe teknologjive audio/video për shmangien e kontaktit traumatizues me autorët e veprave penale. Megjithëse në disa segmente infrastrukturore dhe në konsolidimin e regjistrave të unifikuar të profesionistëve të trajnuar mbeten ende hapa për t’u plotësuar, drejtimi i reformës është i qartë: garantohet gjithnjë e më shumë akses real, i pandërprerë dhe i mbrojtur i fëmijëve në shërbime të drejtësisë miqësore, me fokus të veçantë tek kategoria më e pambrojtur dhe tek respektimi i interesit më të lartë të fëmijës.


Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit të Katërt Politik “Drejtësia penale që mundëson parandalimin e ripërfshirjes së fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërizimin dhe riintegrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin” konstatohet në:

19 masa të zbatueshme për JANAR
QERSHOR 2025



Zbatimi i Qëllimit të Katërt të Politikës, “Drejtësia penale që mundëson parandalimin e ripërfshirjes së fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërizimin dhe riintegrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin”, po konsolidohet nëpërmjet specializimit të aktorëve të drejtësisë dhe forcimit të mekanizmave alternativë ndaj dënimeve klasike. Të gjitha çështjet penale me të mitur trajtohen nga gjyqtarë të specializuar, ndërsa Prokuroria e Përgjithshme ka forcuar kuadrin udhëzues për zbatimin e masave të shmangies nga ndjekja penale dhe drejtësisë restauruese, duke përfshirë fletëpalosje informuese dhe udhëzime specifike për trajtimin e të miturve. Shërbimi i Provës dhe njësitë vendore të mbrojtjes së fëmijëve po kontribuojnë në hartimin dhe zbatimin e masave detyruese edukuese, planeve të këshillimit dhe vlerësimeve individuale, me fokus rifillimin e shkollimit, përfshirjen në kurse profesionale dhe mbështetjen psiko-sociale, në bashkëpunim me strukturat gjyqësore, prokuroritë dhe policinë.

Në fushën e riintegritimit, vihet re një rritje e bashkëpunimit ndërinstitutional ndërmjet institucioneve penitenciare, Shërbimit të Provës, njërive të mbrojtjes së fëmijëve dhe Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, përmes protokolleve të posaçme referimi, marrëveshjeve për



arsimin dhe formimin profesional, programeve rehabilituese brenda dhe pas vuajtjes së dënimit, si dhe ndjekjes së rasteve të lirimit me mbështetje konkrete në komunitet. Praktikrat në IM Kavajë, përfshirë programet arsimore, profesionale, këshillimet familjare dhe kontaktin e strukturuar me shërbimet në nivel vendor, tregojnë një orientim të qartë drejt rishoqërimit të qëndrueshëm të të miturve dhe reduktimit të rrezikut të përsëritjes së veprës penale. Megjithëse mbeten sfida si mungesa e specialistëve të dedikuar në çdo nivel, boshllëqet infrastrukturore në disa shërbime, vështirësitë sociale dhe ekonomike të fëmijëve dhe familjeve të tyre, si dhe kufizimet në monitorimin e plotë të ripërfshirjes, hapat e ndërmarrë tregojnë një drejtim të qëndrueshëm drejt një sistemi penal për të mitur më mbështetës, më gjithëpërfshirës dhe më të orientuar tek riintegrimi real i fëmijës në shoqëri.

DRAFT

II. METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE PERFORMANCËS

Metodologjia e Raportit të Monitorimit, përshkruan procesin e ndjekur gjatë hartimit të raportit dhe ka si qëllim kryesor të mundësoj udhëzimet e nevojshme për lehtësimin në kuptueshmërinë e tij, si dhe të orientohet drejt prezantimit të rezultateve kryesore për të nxjerrë në pah arritjet, sfidat dhe rekomandimet e adresuara për përmirësim. Për të siguruar një proces monitorimi bazuar në arritje konkrete, Ministria e Drejtësisë realizon komunikime intensive me përfaqësuesit e strukturave të përfshira në Planin e Veprimit, me qëllim prezantimin e drejtë dhe të qartë të rezultateve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës së raportimit. Kështu, gjatë periudhës hartuese, është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm (verbal dhe zyrtar) në varësi të specifika ve për plotësimin e dokumentave raportues me disa prej institucioneve të përfshira në strategji, me qëllim evidentimin e rasteve të suksesit, të cilat kanë sjellë rezultate të dukshme në veprimtarinë e tyre, gjithashtu identifikimin e sfidave, problematikave dhe komponentëve të cilët kanë ndikuar apo penguar progresin apo zbatimin e aktiviteteve të parashikuara.

Gjithashtu, gjatë periudhës Janar – Qershor 2025, me mbështetjen e institucioneve bashkëpërgjegjëse në raportim është mbledhur informacion mbi zbatimin e masave dhe aktiviteteve në Planin e Veprimit.

Ky raportim përfshin masat të cilat fillojnë zbatimin e tyre në vitin 2025 si dhe masat të cilat raportohen janë raportuar të palotësuara në 2024.

Ministria e Drejtësisë, harton raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët prodhojnë informacion të nevojshëm për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SNDM-së për vitet e ardhshme, raporte të cilat publikohen në faqen zyrtare të MD-së.

Ministria e Drejtësisë ka hartuar raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS miratuar me vendimin nr. 290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS

➤ **Koordinimi institucional për hartimin e raportit të monitorimit dhe performancës**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 128, dt. 08.11.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues si dhe hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive. Ky sektor kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SNDM 2022-2026) për periudhën 1 janar deri më 31 qershor 2025, është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontributore të planit të veprimit.

➤ **Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Ministria e Drejtësisë, harton raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SNDM (2022-2026) raporte të cilat publikohen në linkun: www.drejtesia.gov.al/strategjia-ndersektoriale-2/

➤ **Fazat e ndjekura për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës**

Fazat që janë ndjekur për përgatitjen dhe konsolidimin e raportit të monitorimit dhe performancës, paraqiten si më poshtë:

- Kërkesa për kontribut në rrugë elektronike u dërgua në datë 8 korrik 2025 tek të gjitha institucionet raportuese në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;
- Hartimi i draftit të parë të raportit të performancës tetor 2025;
- Dërgimi për konsultim publik në datën 10 nëntor 2025;
- Mbledhja e komenteve/sugjerimeve/dakordësisë, mbi masat/aktivitetet nga konsultimi publik dhe reflektimi i tyre në Raportin e Monitorimit 6-mujor
- Zhvillimi i takimit të Ekipit Tematik në kuadër të prezantimit dhe miratimit të draft Raportit të Monitorimit për periudhën janar-qershor

- Publikimi i Raportit 6 mujor të Monitorimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;
- Dërgimi i procedurave të mbledhjes (minutat e takimit, konkluzionet operationale, raporti i konsultimit publik) dhe paketa finale, së bashku me linkun e publikimit për njohje SASPAC datën.

➤ Metodologjia e analizimit të të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës

Raporti shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur grafikë, analiza të thelluara, edhe vizualisht përmes tabelave. Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës për Qëllimet e Politikave dhe Objektivet Specifikë.

Analiza mbi progresin e realizimit të Qëllimeve Politike ndjek një qasje të strukturuar. Progresi lidhur me secilin Qëllim Politik është analizuar në përgjithësi sipas Objektiveve Specifikë (OS) përkatës. Në vijim, për secilin OS është paraqitur një përmbledhje e rezultateve sasiore dhe cilësore të zbatimit të masave përkundrejt kryerjes së veprimeve për realizimin e tyre nga institucio net përgjegjëse, analiza e risqeve dhe veprimeve për adresimin e tyre (sipas rastit) dhe analiza e treguesve të performancës, nëse kjo ka qenë e mundur mbi bazën e të dhënave të paraqitura nga institucionet përgjegjëse. Prezantimi i rezultateve mbi zbatimin e masave ndjek numërimin e Planit të Veprimit dhe është prezantuar me sfond me ngjyrë sipas nivelit të zbatimit (të zbatuara plotësisht/ të zbatuara pjesërisht/ të pazbatuara).

Disa masa rezultojnë të pazbatueshme dhe janë paraqitur me sfond të bardhë. Ato përfshijnë: (i) masat afati i zbatimit i të cilave fillon pas periudhës aktuale të raportimit; (ii) masa të cilat nuk mund të zbatohen nga institucioni raportues për arsye të cilat nuk varen nga institucioni (p.sh. mungesë e kompetencave).

➤ **Përcaktimi i nivelit të zbatimit të masave** është ai i raportuar nga secili institucion përgjegjës, dhe është evidentuar në kontributet e përcjella prej tyre mbi çdo masë të përcaktuar. Shkalla e zbatimit të masave është përcaktuar si më poshtë:

- ✓ **E zbatuar**: masa e cila është përmbushur plotësisht;
- ✓ **Pjesërisht e zbatuar/Në proces**: masa e cila në periudhën e raportimit ka pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijon të jetë në zbatueshmëri;
- ✓ **E pazbatuar**: masa e cila nuk ka pasur zhvillim dhe progres për periudhën raportuese.

Përcaktimi i nivelit të realizimit të OS është përlllogaritur si mesatarja e përqindjes së zbatimit të masave përkatëse. Analiza në nivelin e mesatares së përqindjes së zbatimit të masave pasqyron në mënyrë më të drejtpërdrejtë arritjet lidhur me Objektivat Specifikë në periudhë janar-qershor 2024.

Përcaktimi i nivelit të realizimit të Qëllimeve të Politikave është përlllogaritur si mesatarja e përqindjes së realizimit të Objektiveve Specifikë përkatës.

➤ Konsultimi publik i raportit të monitorimit dhe performancës

Një komponent i rëndësishëm i mirëqeverisjes që ndërlidhet me rritjen e cilësisë së llogaridhë nies dhe transparencës së institucioneve publike si dhe forcimin e demokracisë është procesi i konsultimit publik. Tashmë korniza rregullatore për konsultimin publik është unifikuar dhe ka ndikuar në përmirësimin e transparencës dhe cilësisë së politikave. Prioritare mbetet përfshirja aktive e publikut dhe shoqërisë civile në proceset e politikbërjes. Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi në datën 10 nëntor dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe e publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtesia.gov.al, në menu www.drejtesia.gov.al/konsultime/. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë reflektoi komentet/sugjerimet relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar, në kuadër të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimit të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit. Pas miratimit të raportit, Ministria e Drejtësisë publikoi në faqen e saj zyrtare raportin në gjuhën Shqipe



DRAFT





DRAFT

I. VLERËSIMI I ARRITJES SË QËLLIMEVE TË POLITIKËS KUNDREJT MASAVE DHE AKTIVITETEVE

QËLLIMI I PARË I POLITIKËS

“Parandalimi i veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre, përmes edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fëmijëve”.

Qëllimi i Parë i Politikës: 12 masa



Gjatë periudhës raportuese, janë bërë hapa të mëtijshëm drejt arritjes së Qëllimit të Parë të Politikës. Nga 12 masat e zbatueshme për vitin 2024, 6 masa u zbatuan plotësisht, 5 masë u zbatuan pjesërisht dhe 1 masë e pazbatuar. **50%** e masave janë realizuar plotësisht për periudhën raportuese.


Plani i Veprimit parashikon 10 (dhjetë) masa për O.S 1.1 dhe 2 (dy) masa për O.S 1.2. Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (*të zbatuara plotësisht*/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara).

➤ Objektivi Specifik 1.1.

“Informim/edukim/ndërgjegjësim në qarqet e targetuara për parandalimin e veprave penale ndaj fëmijëve dhe të kryera prej tyre dhe qasja në drejtësinë miqësore në çdo kohë për çdo fëmijë”.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.1 parashikon 10 masa, prej të cilave 6 masa janë zbatuar plotësisht, 3 masa zbatuar pjesërisht dhe 1 masë është e pazbatuar. **60%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 1.1: 10 MASA



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- AKAP dhe institucionet arsimore parauniversitare kanë vijuar të jenë bërthama e informimit dhe edukimit ligjor e social të fëmijëve, duke integruar në programet mësimore temat mbi të drejtat e fëmijëve, parandalimin e dhunës, bullizmit, përdorimit të drogave dhe pasojave ligjore të sjelljeve devijante. Mësuesit kujdestarë, stafi mësimor, psikologët shkollore dhe oficerët e sigurisë kanë bashkëpunuar për trajtimin e rasteve, fuqizimin emocional të nxënësve dhe krijimin e një klime të sigurt në shkollë. Përmes anketave me prindër dhe nxënës, është konfirmuar rritje e kënaqshmërisë dhe ndërgjegjësimit, ndërsa lënda “Qytetari” dhe fushat “Shoqëria dhe mjedisi” janë përdorur si platforma kyçe për edukim mbi të drejtat, përgjegjësitë dhe qasjen në drejtësi miqësore.
- Oficerët e sigurisë dhe strukturat e policimit në komunitet kanë zhvilluar takime periodike informuese në shkollë, duke ofruar njohuri praktike mbi shmangien e konflikteve, rreziqet e përfshirjes në vepra penale, sigurinë online dhe ndikimin e drogave, si dhe duke forcuar lidhjen mes shkollës, familjes dhe institucioneve të rendit. Në institucionet ku mungon oficeri i sigurisë, këtë rol e kanë mbuluar grupet antibullizëm dhe shërbimet psiko-sociale, ndërsa në shumë raste informacioni është dhënë në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, NJMF-të dhe aktorë lokalë, duke e bërë parandalimin më të qëndrueshëm dhe të integruar.
- Avokati i Popullit ka vepruar në mënyrë proaktive duke organizuar rreth 30 ditë të hapura dhe aktivitete informuese në shkollë dhe me OJF-të, për të rritur njohjen e rolit të tij dhe të Komisionerit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve. Përmes bashkëbisedimit të drejtpërdrejtë me fëmijët, prindërit dhe mësuesit, janë promovuar të drejtat e fëmijëve, mekanizmat e ankimimit dhe mbrojtjes, si dhe janë adresuar shqetësimet që fëmijët kanë lidhur me sigurinë, dhunën dhe qasjen në drejtësi miqësore.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka forcuar dimensionin e barazisë dhe respektit në mjediset shkollore dhe komunitare, përmes tryezave teknike në Korçë për rastet e identifikuara të fëmijëve, aktiviteteve gjatë “Javës kundër Diskriminimit”, takimeve me maturantët për të drejtat, bullizmin dhe gjuhën e urrejtjes, si dhe pritjes së grupeve të nxënësve në zyrat e tij me materiale të përshtatura për fëmijë. Këto ndërhyrje kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe në fuqizimin e mekanizmave mbrojtës kundër diskriminimit dhe dhunës ndaj fëmijëve.
- Zyra e Komisionerit për të Dhënat Personale ka ndërthurur mbrojtjen e privatësisë me parandalimin e rreziqeve digjitale, duke organizuar aktivitete sensibilizuese në kuadër të “Privacy Day” me nxënës, mësues e prindër, si dhe duke kryer hetime administrative dhe dhënë rekomandime specifike për qendrat që ofrojnë mbrojtje për viktimat e trafikimit, për të garantuar mbrojtjen e të dhënave sensitive të fëmijëve. Kjo ka forcuar standardet e sigurisë së të dhënave dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e tyre.

- ✚ DNJF (Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas) ka avancuar ndjeshëm informimin ligjor të fëmijëve dhe familjeve të tyre, duke përditësuar informacionin online në gjuhë të thjeshtëzuar, duke përgatitur fletëpalosje, postera dhe video mbi ndihmën juridike falas, përfshirë edhe përkthimin në gjuhën e shenjave. Materialet janë shpërndarë gjerësisht në shkolla dhe institucione, duke e bërë më të qartë të drejtën për akses në shërbime juridike miqësore për çdo fëmijë.
- ✚ Qendra për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) ka ruajtur rolin e saj informues përmes videove dhe materialeve ekzistuese online, broshurave dhe fletëpalosjeve të shpërndara në shkolla dhe tryeza teknike, duke mbështetur aktorët e sistemit të drejtësisë për të mitur me udhëzime praktike. Ndërkohë, gjatë periudhës raportuese nuk janë publikuar materiale të reja, por burimet ekzistuese kanë vijuar të përdoren në funksion të ndërgjegjësimit.
- ✚ MSHMS ka kontribuar në promovimin e gjuhës gjithëpërfshirëse dhe mbrojtjes së fëmijëve përmes aktiviteteve sensibilizuese në ditët e shënuara, si dhe përmes fjalorthit për gjuhën gjithëpërfshirëse dhe trajnimeve me komunitetin dhe prindërit, veçanërisht në kuadër të projektit “Askush të mos mbetet pas”. Këto iniciativa kanë forcuar qasjen miqësore dhe jo diskriminuese ndaj fëmijëve, përfshirë ata me aftësi të kufizuara.
- ✚ Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me bashkitë dhe NJMF-të, ka zhvilluar sesione edukimi në institucionet e përkujdesit social dhe shkolla, duke trajtuar tema mbi dhunën, bullizmin, trafikimin, sigurinë online dhe fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe duke informuar për shërbimet e drejtësisë miqësore dhe mekanizmat e referimit. Përmes këtij rrjeti, është forcuar mbrojtja e fëmijëve më vulnerabël.
- ✚ AMA ka luajtur një rol mbrojtës në hapësirën mediatike, duke monitoruar përmbajtjet televizive dhe reklamat në raport me standardet për mbrojtjen e fëmijëve dhe duke ndërmarrë masa konkrete në rastet e shkeljeve. Identifikimi i përmbajtjeve të papërshtatshme, dërgimi i tërheqjeve të vëmendjes dhe vendosja e gjobave, veçanërisht për përmbajtje të dhunshme, seksiste apo denigruese në orare të aksesueshme nga fëmijët, kanë kontribuar në një mjedis më të sigurt informimi.
- ✚ Bashkia Kamëz ka realizuar aktivitete të shumta ndërgjegjësuere në bashkëpunim me OJF-të dhe NJMF, me fokus të veçantë tek komunitetet rom dhe egjiptian, për rëndësinë e arsimit, parandalimin e braktisjes së shkollës dhe informimin mbi të drejtat dhe shërbimet mbrojtëse. Takimet derë më derë me prindër dhe fëmijë kanë rritur aksesin real në informacion dhe shërbime.
- ✚ Bashkia Lushnje ka zhvilluar takime të gjera informuese në shkolla, komunitete dhe qendra sociale me tema mbi të rinjtë në konflikt me ligjin, krimet dhe abuzimet online, sigurinë në internet dhe pasojat ligjore e psikologjike të sjelljeve devijante. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve ka kombinuar këtë informim me vizita familjare, vlerësim rreziku dhe hartim planesh individuale, duke lidhur parandalimin me ndërhyrjen konkrete dhe riintegrimin.
- ✚ Bashkia Durrës ka zhvilluar rreth 70% të aktiviteteve të planifikuara për OS1, në bashkëpunim me qendrat multifunktionale, shkollat, qendrat rinore dhe organizatat partnere, duke adresuar internetin e sigurt, dhunën, bullizmin dhe fuqizimin social-kulturor të të rinjve. Përmes kësaj qasjeje komunitare, është forcuar mbrojtja e fëmijëve dhe është promovuar pjesëmarrja aktive në mjedise të sigurta.
- ✚ Bashkia Vlorë ka organizuar takime të përsëritura me fëmijë, prindër dhe komunitetin për parandalimin e braktisjes së shkollës, veprimeve penale dhe rrezikut të trafikimit, në bashkëpunim me NJMF, policinë e zonës dhe shërbimet sociale. Fushatat gjatë muajit antitrafik dhe 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore kanë forcuar mesazhet mbi sigurinë dhe të drejtat e fëmijëve.
- ✚ Bashkia Berat ka ndërthurur takimet informuese për rëndësinë e arsimit, mbështetjen me bursa për fëmijët nga familjet e varfra dhe komuniteti rom, edukimin për zgjidhjen paqësore të konflikteve në shkolla dhe përfshirjen e prindërve në programe prindërimi pozitiv. Në bashkëpunim me Qendrën “Vatra” dhe Zyrat e Punës, janë ofruar edhe mundësi formimi profesional për të rinjtë në rrezik.
- ✚ Bashkia Tiranë ka fokusuar punën në identifikimin dhe asistimin e fëmijëve në situatë rruge dhe jashtë sistemit arsimor, përmes planeve të posaçme të masave, bashkëpunimit me SPZ-të dhe NJMF-të dhe organizimit të klubeve të prindërimit në njësitë administrative. Edhe pse mungon një program specifik



komunikimi për fëmijët jashtë shkolle, janë realizuar takime dhe informim mbi mbrojtjen nga shfrytëzimi, trafikimi dhe veprat penale.

✚ Bashkia Pukë dhe bashkitë e tjera të përfshira raportojnë funksionim aktiv të Grupeve Teknike Ndërsektoriale dhe mungesë rastesh të braktisjes së shkollës, duke treguar një nivel të mirë monitorimi dhe reagimi të hershëm ndaj rreziqeve për fëmijët.

✚ AKSP dhe partnerët lokalë kanë organizuar fushata ndërgjegjësimi për parandalimin e trafikimit të fëmijëve, mosbraktisjen e shkollës dhe përfshirjen e fëmijëve në aktivitete sociale, lojëra dhe kampe verore, duke i afruar fëmijët me mjedise të sigurta dhe modele pozitive sjelljeje.

DRAFT




DRAFT

➤ Objektivi Specifik 1.2.

Fuqizimi i mekanizmave të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve ku janë përfshirë fëmijë.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.2 parashikon parashikon 2 masa, prej të cilave janë zbatuar pjesërisht. **100%** e masave janë zbatuar pjesërisht.

Objektivi Specifik 1.2: 2 masa



- ✚ AMA gjatë kësaj periudhe ka forcuar rolin e saj si mekanizëm mbrojtës dhe parandalues, duke theksuar para OSHMA-ve detyrimin për të respektuar oraret e transmetimit, sinjalistikën, trajtimin etik të rasteve që përfshijnë fëmijë dhe mbrojtjen e privatësisë së tyre, në mënyrë që të mos cenohen dinjiteti dhe zhvillimi i tyre emocional. Në vijim, AMA ka ndërmarrë hapa konkretë për transpozimin e EMFA dhe DSA në kuadrin ligjor kombëtar, ka zhvilluar tryeza pune me ekspertizë ndërkombëtare dhe ka zgjeruar rubrikën “Edukimi Mediatik”, përmes materialeve sensibilizuese, aktiviteteve me nxënës dhe fushatave mbi sigurinë online, inteligjencën artificiale, lojërat online dhe përdorimin e përgjegjshëm të mediave, duke krijuar një mjedis më të sigurt që redukton rrezikun e viktimizimit dhe nxit qasje mbrojtëse e jo ndëshkuese ndaj fëmijëve.
- ✚ Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror ka kontribuar drejtpërdrejt në fuqizimin e mekanizmave miqësorë për fëmijët, duke marrë pjesë në hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri organik dhe duke adresuar boshllëqet ligjore të konstatuara në praktikat përmbarimore. Gjatë janar-qershor 2025 janë prioritarizuar çështjet që lidhen me pensionin ushqimor, kujdestarinë dhe takimin me fëmijën, është vendosur raportim periodik statistikor dhe janë zhvilluar takime me Urdhrin e Psikologut dhe OJF për të garantuar mbështetje psiko-sociale falas dhe ambiente të përshtatshme për ekzekutimin e vendimeve “takim/marrje fëmije”. Këto masa rrisin mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës dhe ulin rrezikun e konflikteve të ashpra mes prindërve, duke krijuar hapësirë për zgjidhje më të buta dhe të ndërmjetësuar.
- ✚ Bashkia Kamëz, përmes Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, ka përdorur punonjës me eksperiencë për të menaxhuar rastet e fëmijëve në nevojë ose në rrezik,

duke ofruar mbështetje sociale, ekonomike dhe psiko-sociale dhe duke lehtësuar zgjidhjen e konflikteve familjare pa arritur në përshkallëzim penal. Në 99 rastet e trajtuara janë përdorur mjete mbështetëse (bonus qiraje, ndihmë ekonomike, pako ushqimore, shërbime të OJF-ve), duke i orientuar prindërit dhe fëmijët drejt ndërhyrjeve restauruese dhe parandalimit të cenimeve të mëtejshme të të drejtave.



- ✚ Shërbimi i Provës ka vijuar të zbatojë dhe përmirësojë praktikën ekzistuese ligjore që lidhen me masat alternative dhe mbikëqyrjen në komunitet për të miturit, duke mbështetur vendosjen e masave edukative dhe sociale në vend të dënimit tradicional. Përmes bashkëpunimit me bashkitë, NJMF-të dhe institucionet e tjera, Shërbimi i Provës ka ndikuar në përforcimin e një qasjeje restauruese ku vlerësimi individual i fëmijës dhe planet e personalizuar shihen si mjete kyçe për parandalimin e ripërfshirjes në vepra penale.
- ✚ Avokati i Popullit, përmes Seksionit për të Drejtat e Fëmijëve dhe Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka luajtur rol mbikëqyrës dhe korrektues në raport me institucionet që trajtojnë fëmijë në kontakt me ligjin. Me 10 rekomandime të adresuara institucioneve publike dhe një inspektim të dedikuar në Institutin e të Miturve Kavajë, AP ka kërkuar përmirësime konkrete në kushtet e akomodimit, shëndetit, sigurisë, trajtimit multidisiplinar dhe programeve rehabilituese, duke shtyrë sistemin drejt një modeli trajtimi më njerëzor, jo ndëshkues dhe realisht restaurues për të miturit.
- ✚ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndikuar në kuadrin normativ për një qasje më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse ndaj të miturve, përfshirë përmes rekomandimeve mbi projektligjin “Për vullnetarizmin”, ku janë siguruar garanci që vullnetarët e huaj të mitur të gëzojnë të drejta të barabarta me ata shqiptarë. Këto ndërhyrje mbështesin parimin e mosdiskriminimit dhe krijojnë bazë që mekanizmat restaurues dhe programet komunitare të jenë të hapura, të sigurta dhe të barabarta për të gjithë fëmijët.
- ✚ Prokuroria e Përgjithshme, me miratimin e udhëzimit nr. 1/2025 si shtesë të udhëzimit ekzistues për çështjet me të mitur, ka forcuar arkitekturën profesionale të drejtësisë penale për të mitur duke nxitur bashkëpunimin mes prokurorëve, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe krijimin e Rrjetit të Prokurorëve të Drejtësisë Penale për të Mitur. Ky rrjet synon rritjen e përdorimit të masave të shmangies nga procedimi penal, drejtësisë restauruese dhe trajtimeve alternative, duke ulur varësinë nga dënimet tradicionale dhe duke promovuar zgjidhje që vendosin në qendër rehabilitimin e fëmijës.
- ✚ Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar të zbatojë kuadrin rregullator për përdorimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave për Drejtësinë Penale për të Mitur, duke mbështetur transparencën, analizën dhe monitorimin e trajtimit të fëmijëve në sistemin gjyqësor. Përmes pjesëmarrjes në seminare të specializuara dhe forcimit të specializimit të gjyqtarëve për çështjet e të miturve, KLGJ kontribuon në një jurisprudencë më koherente, të ndjeshme dhe të orientuar drejt mekanizmave alternativë dhe restaurues.

QËLLIMI I DYTË I POLITIKËS

“Një kuadër ligjor, institucional dhe me profesionistë që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë”.

Qëllimi i Dytë i Politikës: 23 masa

23 masa të zbatueshme për periudhën



Plani i Veprimit për Qëllimin e Dytë të Politikës parashikon 23 masa, prej të cilave 10 masa janë zbatuar plotësisht dhe 6 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 7 masa të pazbatuara **44%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Plani i Veprimit parashikon 10 (dhjetë) masa për O.S 2.1, 11 (njëmbëdhjetë) masa për O.S 2.2 dhe 2 (dy) masa për O.S 2.3.


Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (*të zbatuara plotësisht/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara*).

➤ Objektivi Specifik 2.1

Kuadri ligjor dhe politikat institucionale garantojnë akses te një drejtësi miqësore për çdo fëmijë.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.1 parashikon 10 masa, prej të cilave 3 masa janë zbatuar plotësisht, 4 masa rezultojnë të zbatuara pjesërisht dhe 3 masa të pazbatuara **30%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 2.1: 10 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- ✚ Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror Gjatë janar-qershor 2025 ka forcuar dukshëm bazën ligjore dhe mbikëqyrjen institucionale për çështjet që lidhen me fëmijët. Janë identifikuar boshllëqe ligjore përmes hetimeve administrative dhe janë propozuar ndryshime pranë MD-së. Është kontribuar në hartimin e katër akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri organik, me fokus veçantë tek procedurat për “pension ushqimor”, “kujdestari” dhe “takim me fëmijë”. Janë zhvilluar takime me Urdhrin e Psikologut dhe OJF-të për ofrimin falas të mbështetjes psikologjike dhe krijimin e ambienteve miqësore për fëmijë në Zyrën Përmbarimore Tiranë. Në 22 zyra vendore janë kryer inspektime dhe është vendosur raportim periodik statistikor për të gjitha çështjet që prekin fëmijët, duke siguruar prioritet, transparencë dhe respektim të interesit më të lartë të fëmijës në ekzekutimin e vendimeve.
- ✚ Bashkia Kamëz Përmes Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe bashkëpunimit me OJF-të, bashkia ka përdorur profesionistë me eksperiencë për menaxhimin e rasteve që kërkojnë mbrojtje, duke i adresuar ato me masa mbështetëse konkrete si bonus qiraje, ndihmë ekonomike, raste të veçanta dhe pako ushqimore. Kjo qasje e integruar sociale forcon mbrojtjen e fëmijëve, ul ekspozimin e tyre ndaj konflikteve ligjore dhe krijon një mekanizëm praktik që mundëson akses real tek mbështetja dhe drejtësia miqësore.
- ✚ Shërbimi i Provës Ka vijuar konsolidimin e praktikave ligjore dhe institucionale për trajtimin e të miturve në komunitet, duke mbështetur përdorimin e masave alternative ndaj dënimit me burgim dhe duke kontribuar në përditësimin dhe zbatimin koherent të kuadrit ligjor për drejtësinë penale miqësore për të mitur. Roli i tij në vlerësimin individual dhe në monitorimin e masave jo-custodiale forcon dimensionin restaurues dhe parandalues të sistemit.
- ✚ Avokati i Popullit (AP)Nëpërmjet Seksionit për të Drejtat e Fëmijëve ka adresuar 10 rekomandime konkrete ndaj institucioneve qendrore e vendore për garantimin e të gjitha të drejtave të fëmijëve, duke ndjekur zbatimin e tyre në mënyrë sistematike. Përmes MKPT ka inspektuar IM Kavajë dhe ka dhënë një paketë rekomandimesh shumë specifike për kushte më dinjitoze, trajtim multidisiplinar, shërbime shëndetësore, siguri dhe programe arsimore/profesionale, duke shtyrë sistemin drejt përputhjes me standardet e drejtësisë miqësore dhe mbrojtjes nga trajtimi çnjerëzor.
- ✚ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) Ka ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e kuadrit ligjor, veçanërisht përmes rekomandimeve mbi projektligjin “Për vullnetarizmin”, duke siguruar që vullnetarët e huaj të mitur të trajtohen në mënyrë të barabartë me shtetasit shqiptarë. Kjo ndërhyrje forcon parimin e mosdiskriminimit dhe harmonizon legjislacionin me standardet e mbrojtjes së fëmijëve.
- ✚ Prokuroria e Përgjithshme (PP) Me udhëzimin nr. 1/2025 ka fuqizuar dimensionin profesional dhe bashkëpunues të prokurorëve që trajtojnë çështje me të mitur, duke nxitur shkëmbimin e praktikave më të mira dhe krijimin e Rrjetit të Prokurorëve të Drejtësisë Penale për të Mitur. Ky mekanizëm synon zbatim më koherent të kuadrit ligjor, përdorim më të gjerë të masave alternative dhe garantimin që ndjekja penale ndaj të miturve të jetë në funksion të interesit më të lartë të fëmijës.
- ✚ Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) Ka vijuar zbatimin e udhëzimit për përdorimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur nga gjykatat, duke forcuar mbledhjen, analizën dhe transparencën e të dhënave mbi trajtimin e fëmijëve në sistemin gjyqësor. Pjesëmarrja në seminare të specializuara dhe fokusimi te praktikat krahasuese kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe orientimin e jurisprudencës drejt standardeve miqësore për fëmijët.
- ✚ Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) Ka vepruar si garantues normativ dhe praktik i mbrojtjes së të miturve në mjedisin mediatik. Përmes Kodit të Ri të Transmetimit dhe reagimeve publike ndaj shkeljeve, AMA ka kërkuar respektimin rigoroz të rregullave për përmbajtjet që prekin fëmijët, duke adresuar transmetimet me dhunë, pamje degraduese apo cenim të dinjitetit të tyre. Paralelisht, ka zhvilluar rubrikën “Edukimi Mediatik” me materiale sensibilizuese për sigurinë online, përdorimin e teknologjisë dhe rreziqet e lojërave online, si dhe ka nisur transpozimin e EMFA dhe DSA në ligjin organik për të rritur


kapacitetet mbikëqyrëse dhe për të garantuar një mjedis informimi më të sigurt, transparent dhe gjithëpërfshirës për fëmijët.

➤ Objektivi Specifik 2.2

Koordinimi dhe bashkërendimi mes institucioneve me qëllim forcimin e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.2 parashikon parashikon 11 masa, prej të cilave rezulton se 5 masa janë të zbatuara plotësisht dhe 2 masa janë të zbatuara pjesërisht dhe 4 masa të pazbatuara. **46%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 2.2: 11 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB)** Sistemi penitenciar ka konsoliduar bazën profesionale për punën me të miturit, përmes miratimit, përditësimit dhe publikimit të kurrikulës së formimit fillestar për stafin e institucioneve për të mitur, të aksesueshme publikisht. Është krijuar dhe administrohet një regjistër i profesionistëve të trajnuar mbi drejtësinë miqësore për fëmijët, ndërsa në faqen zyrtare janë publikuar edhe “Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijëve”, duke e bërë kuadrin orientues të qartë, të aksesueshëm dhe të unifikuar për të gjithë stafin.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor & Shkolla e Magjistraturës (KLGJ/SHM)** Përmes një sërë trajnimesh të specializuara, sistemi gjyqësor ka forcuar ndjeshëm kapacitetet për trajtimin e çështjeve që përfshijnë fëmijë. SHM ka realizuar formime mbi të drejtat e viktimave, “personin e besuar”, dhunën në familje, barazinë gjinore, shfrytëzimin seksual online të të miturve, drejtësinë miqësore, teknikat e intervistimit të fëmijëve, kujdestarinë alternative dhe zbatimin e Konventës së Hagës për rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijës. KLGJ vijon zbatimin e rregullave për caktimin e gjyqtarëve të specializuar për çështjet e të

miturve dhe përdorimin e sistemit të integruar të të dhënave për drejtësinë penale për të mitur, duke siguruar koherencë, profesionalizëm dhe specializim në trajtimin gjyqësor të fëmijëve.

✚ **Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror** Është bërë një hap cilësor drejt profesionalizimit dhe koordinimit institucional përmes miratimit të programeve të strukturuar të formimit fillestar dhe vazhdues për përmbartuesit, trajnimit të detyrueshëm për përmbartuesit në periudhë prove dhe nënshkrimit të marrëveshjeve me Shkollën e Magjistraturës dhe Urdhrin e Psikologut për trajnime të përbashkëta dhe mbështetje psikologjike falas në çështjet që prekin fëmijët. Të gjitha aktet ligjore, nënligjore dhe marrëveshjet janë publikuar dhe shpërndarë sistematikisht, shoqëruar me analiza periodike për ekzekutimet që lidhen me “pension ushqimor”, “takim me fëmijë” dhe “kujdestari”, duke rritur transparencën, llogaridhënien dhe fokusin te interesi më i lartë i fëmijës, edhe pse regjistri i unifikuar kombëtar i profesionistëve të trajnuar mbetet ende në proces.

✚ **Policia e Shtetit (DPPSH)** Policia ka institucionalizuar trajnimin e vazhdueshëm mbi Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ligjin për të drejtat e fëmijës përmes Programit të Trajnimit të Detyrueshëm në Shërbim. Janë zhvilluar trajnime tematike për hetimin e trafikimit të të miturve, intervistimin e viktimave dhe autorëve të mitur, si dhe bashkëpunime me organizata si ARSIS dhe partnerë ndërkombëtarë. Janë realizuar aktivitete sensibilizuese në shkolla për sigurinë në internet dhe rreziqet online, si dhe është forcuar kapaciteti hetimor për krimet seksuale/pornografinë online me të mitur përmes pajisjeve dhe programeve të dedikuara. Studimi kërkimor 10-vjeçar për përfshirjen e të miturve në krim është kthyer në bazë rekomandimesh praktike për drejtimet e punës policore.

✚ **Prokuroria e Përgjithshme (PP)** Prokuroria ka intensifikuar pjesëmarrjen në mekanizma bashkërendues dhe forcuar fokusin tematik në drejtësinë miqësore për fëmijët, përmes kërkesës për përfshirje të trajnimeve specifike mbi shfrytëzimin seksual online në programet e SHM dhe përmes pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare e rajonale mbi informacionin miqësor për të rinjtë, diversionin dhe drejtësinë restauruese. Këto hapa synojnë harmonizimin e praktikave të ndjekjes penale me standardet për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve në kontakt apo konflikt me ligjin.

✚ **Shërbimi i Provës & Sistemi i Integruar i të Dhënave** Shërbimi i Provës ka kontribuar në forcimin e mekanizmave të përbashkët të drejtësisë për të mitur, përmes funksionimit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, duke mundësuar koordinim më të mirë ndër-institucional, monitorim të rasteve dhe përdorim më efektiv të masave alternative dhe ndërhyrjeve restauruese.

✚ **Qendra për Parandalimin e Krimeve ndaj të Miturve / Qendra e të Miturve (QPKMR)** Stafi i QPKMR ka marrë pjesë në trajnime kombëtare dhe ndërkombëtare me OSBE dhe organizata të tjera, të fokusuara në parandalimin e kriminalitetit tek të rinjtë dhe sfidat e drejtësisë penale për të mitur, duke forcuar rolin e Qendrës si një teknike dhe bashkërenduese në sistem.

✚ **Bashkia Kamëz** Në nivel vendor, Bashkia Kamëz ka ndërtuar një model funksional bashkëpunimi ku NJMF-ja dhe organizatat partnere (UNICEF, World Vision, Nisma-Arsis etj.) punojnë së bashku në trajnim, menaxhim rastesh dhe ndërhyrje mbështetëse. Profesionistët me eksperiencë trajtojnë rastet sipas standardeve ligjore, marrin pjesë në trajnime të përbashkëta me shërbimin e provës dhe aktorë të tjerë, duke siguruar unifikim të praktikave dhe koordinim real në mbrojtje të fëmijëve.

✚ **Bashkia Korçë dhe aktorë të tjerë vendorë** Në Korçë, NJMF dhe institucionet pjesëmarrëse në GTN janë të angazhuara në takime të rregullta dhe bashkëpunim të ngushtë me OJF-të për trajtimin e rasteve të fëmijëve, duke e kthyer koordinimin ndërsektorial në praktikë pune të përditshme. Në bashki të tjera, përfshirë Durrësin, proceset janë në zhvillim, por me hapa drejt standardizimit të trajnimeve dhe bashkërendimit.

➤ Objektivi specifik 2.3

Forcimi i rolit koordinues të Ministrisë së Drejtësisë për çështjet që lidhen me fëmijët dhe mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimmarrja ndikon te fëmijët, bazuar në standardet ndërkombëtare të miratuara në fushë.

Plani i Veprimit për Objektivin 2.3 parashikon parashikon 2 masa prej të cilave rezulton se masë janë zbatuar plotësisht. **100%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 2.3: 2 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- Ministria e Drejtësisë / Qendra për të Mitur (QPKMR)** Gjatë periudhës janar–qershor 2025, Ministria e Drejtësisë, përmes Qendrës për të Mitur dhe Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, ka forcuar rolin e saj koordinues në mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e statistikave që lidhen me fëmijët në kontakt apo konflikt me ligjin. Janë grumbulluar të dhëna nga të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë penale, duke përfshirë 236 raste të trajtuara nga prokuroritë në nivel rrethi dhe apeli, 926 raste të administruara nga zyrat territoriale të Shërbimit të Provës për të miturit me masa alternative ose shmangie nga ndjekja penale, si dhe 109 raste të regjistruara nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ku ndodhen të mitur të dënuar ose të paraburgosur. Këto të dhëna janë standardizuar dhe raportuar përmes platformës unike të raportimit, duke mundësuar për herë të parë ndjekjen e integruar të rasteve të fëmijëve në çdo fazë të procesit penal dhe rritur transparencën ndërinstitucionale.
- Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit** Në drejtim të forcimit të sistemit të raportimit statistik, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka përmirësuar ndjeshëm procesin e evidentimit të çështjeve që përfshijnë fëmijë. Me urdhrin nr. 36, datë 18.03.2025, “Për raportimin mujor mbi veprimtarinë procedurale dhe administrative të zyrave vendore përmbartimore”, janë përditësuar formatet e mbledhjes së statistikave, duke përfshirë indikatorë të posaçëm për çështjet që lidhen me kujdestarinë, pensionin ushqimor dhe të drejtën e takimit me fëmijë. Këto përmirësime kanë garantuar harmonizimin e plotë të raportimeve ndërmjet zyrave vendore dhe nivelit qendror, si dhe rritjen e cilësisë së analizës statistikore.
- Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF)** Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka mundësuar ofrimin e ndihmës juridike për gjithsej 111 fëmijë gjatë periudhës janar–qershor 2025. Nga këto, 61 raste janë trajtuar në fushën administrative, 25 raste në fushën penale dhe 25 raste në fushën civile. Për herë të parë, ndihma juridike është raportuar sipas natyrës së çështjes, duke mundësuar kategorizimin tematik të përfituesve të mitur në përputhje me standardet ndërkombëtare për drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve. Ky zhvillim ka forcuar rolin e DNJF si mekanizëm i aksesit efektiv në drejtësi, duke siguruar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që përfshihen në çështje civile, penale apo administrative.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)** Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar zbatimin e udhëzimeve dhe akteve nënligjore që garantojnë profesionalizmin dhe specializimin në trajtimin e çështjeve që përfshijnë të mitur. Në zbatim të Udhëzimit nr. 79, datë 30.05.2019, dhe vendimit nr. 408, datë 15.07.2025, për miratimin e rregullave mbi kriteret dhe procedurat për krijimin e seksioneve dhe trupave gjykuese, është siguruar që të gjitha çështjet e drejtësisë penale

për të mitur të gjykohe nga gjyqtarë të specializuar. Ky hap ka kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve gjyqësore për fëmijët dhe në respektimin e parimeve të drejtësisë miqësore ndaj tyre.

- ✚ **Bashkitë (shembull: Bashkia Kamëz)** Në nivel vendor, bashkitë janë përfshirë në procesin e forcimit të mekanizmave të mbledhjes së të dhënave statistikore për fëmijët e përfshirë në çështje civile, penale, familjare apo administrative. Bashkia Kamëz ka evidentuar se aktualisht mungon një sistem i unifikuar për këtë kategori të dhënash, por janë ndërmarrë hapa konkretë për ngritjen e një strukture të brendshme raportimi në bashkëpunim me njësitë e mbrojtjes së fëmijëve dhe institucionet vendore të drejtësisë. Këto përpjekje përbëjnë bazën për ndërtimin e një mekanizmi të qëndrueshëm të raportimit lokal, që do të kontribuojë në pasqyrimin më të saktë të ndërveprimit të fëmijëve me sistemin e drejtësisë.



Sfidat e hasura për realizimin e masave të qëllimit të Politikës II:

- ✚ Mungesë harmonizimi të plotë ndërinstitutional dhe statistikor, si në nivel qendror ashtu edhe vendor, për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave që lidhen me fëmijët në sistemin e drejtësisë.
- ✚ Nevoja për përmirësim të kuadrit ligjor dhe nënligjor, veçanërisht në procedurat përmbarimore që përfshijnë fëmijë dhe në zbatimin praktik të drejtësisë miqësore ndaj tyre.
- ✚ Kufizime në burime njerëzore dhe infrastrukturore, që ndikojnë në zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe në ofrimin e shërbimeve mbështetëse psikologjike apo sociale për fëmijët.

QËLLIMI I TRETË I POLITIKË

“Garantimi i qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë. Garantimi i qasjes në çdo kohë në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë”.

Qëllimi i Tretë i Politikës: 10 masa



Plani i Veprimit për Qëllimin e Tretë të Politikës parashikon 10 masa, prej të cilave 3 masa janë zbatuar plotësisht dhe 1 masë janë zbatuar pjesërisht dhe 6 masa të pazbatuara. **30%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Plani i Veprimit parashikon 2 (dy) masa për O.S 3.1, 5 (pesë) masa për O.S 3.2 dhe 3 (tre) masa për O.S 3.3.

Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (*të zbatuara plotësisht/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara*).

➤ Objektivi Specifik 3.1

Qasje për çdo fëmijë në ndihmën juridike të ofruar nga profesionist të trajnuar dhe informacioni me gjuhë miqësore për çdo fëmijë.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.1 parashikon parashikon 2 masa, prej të cilave të dyja masat e zbatuara. **100%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 3.1: 2 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF) ka vijuar forcimin e sistemit të ndihmës juridike falas për fëmijët, duke garantuar qasje të barabartë dhe profesionale në drejtësi përmes strukturave shtetërore dhe partnereve të saj. Aktualisht funksionojnë 20 Qendra të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, të mbështetura nga 14 organizata jofitimprurëse dhe 13 klinika ligjore, ndërsa janë lidhur kontrata me 140 avokatë për ndihmën juridike dytësore, prej të cilëve 30 janë të specializuar për çështje që përfshijnë të mitur. DNJF ka zhvilluar 273 aktivitete ndërgjegjësuere dhe informuese në nivel kombëtar, duke përfshirë fushata sensibilizuese për viktimat e krimit dhe fëmijët si kategori përfituese, shpërndarje materiale të thjeshtëzuara dhe takime informuese në shkolla. Një pjesë e rëndësishme e punës është përqendruar në promovimin e Linjës së Gjellbër 08001010 dhe platformës “Juristi online”, përmes të cilave janë trajtuar 298 raste gjatë periudhës janar–qershor 2025. Në bashkëpunim me OSBE-në dhe ANAD-in janë realizuar materiale në gjuhën Braille dhe trajnime me interpretë të gjuhës së shenjave për të siguruar akses për çdo kategori përfituese. Në bashkëpunim me universitetet, janë zhvilluar trajnime dhe praktika për studentët e Klinikave të Ligjit, me fokus në mënyrën e trajtimit të fëmijëve si përfitues të ndihmës juridike falas. DNJF ka ngritur gjithashtu ekupe lëvizëse që kanë zhvilluar aktivitete informuese në zonat e thella të vendit, si Fushë-Arrëz, Vau i Dejës, Malësi e Madhe, Kamëz, Vorë, Rrogozhinë dhe Peqin.

- Bashkia Korçë ka kontribuar në ndërgjegjësimin për të drejtat e fëmijëve përmes videove edukative të realizuara


nga vetë fëmijët në bashkëpunim me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe DNJF. Në nivel kombëtar, DNJF ka kërkuar nga të gjitha bashkitë publikimin e videos “Çfarë është ndihma juridike dhe si mund të përfitosh” në faqet e tyre zyrtare për të rritur informimin publik mbi të drejtën për ndihmë juridike të garantuar nga shteti.

- ✚ Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar zbatimin e udhëzimit nr. 8/2021 për “Hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur”, duke shpërndarë “Letrën e të drejtave të të miturit” në të gjitha prokuroritë e vendit. Gjithashtu, në faqen zyrtare të institucionit është krijuar një rubrikë informuese e dedikuar për të miturit në konflikt me ligjin, me qëllim ndërgjegjësimin dhe informimin mbi të drejtat e tyre gjatë procedurave penale.

➤ Objektivi Specifik 3.2

Shërbime të drejtësisë miqësore për çdo fëmijë të ofruara në mjedise të aksesueshme për ta.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.2 parashikon parashikon 5 masa, prej të cilave 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 4 masa janë zbatuar pjesërisht. **20%** e masave janë zbatuar plotësisht.



- ✚ Policia e Shtetit: Gjatë periudhës raportuese, Policia e Shtetit ka vijuar përpjekjet për krijimin dhe përmirësimin e njësive miqësore të intervistimit me të mitur në të gjithë vendin. Aktualisht janë në funksion 15 njësi të tilla pranë Drejtorive Vendore të Policisë, përfshirë komisaritet nr. 3, 5 dhe 6 në Tiranë dhe Komisariatin e Policisë Sarandë. Pas anulimit të marrëveshjes me shoqërinë “OUR” për mungesë fondesh, është ruajtur bashkëpunimi me organizatën “CIVI POL”, me të cilën është dakordësuar fillimi i punimeve në shtator 2025 për ndërtimin e një njësie të re të intervistimit miqësor për të mitur pranë godinës së Komisarariatit të Policisë nr. 1 në Tiranë.
- ✚ Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ): Në kuadër të përmirësimit të shërbimeve për fëmijët në kontakt apo konflikt me ligjin, gjykatat kanë vijuar zbatimin e Udhëzimit nr. 79, datë 30.05.2019, dhe të vendimit nr. 408, datë 15.07.2025, “Mbi miratimin e rregullave për kriteret dhe procedurat e krijimit të seksioneve dhe trupave gjyqësorë”. Të gjitha çështjet penale që përfshijnë të mitur gjykojnë nga gjyqtarë të specializuar, duke siguruar standarde më të larta profesionale dhe mbrojtje më të mirë të interesave të fëmijëve. Gjykatat që ushtrojnë veprimtarinë në godina të reja të ndërtuara gjatë dekadës së fundit kanë tashmë të plotësuar standardet për mjedise miqësore dhe aksesueshmëri për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara. Për gjykatat që janë parashikuar të ndërtohen sipas hartës së re gjyqësore, standardet për aksesueshmëri dhe ambientet e përshtatshme për fëmijët janë përcaktuar në detyrat e projektimit. Po ashtu, të gjitha gjykatat janë pajisur me sisteme audio-video që mundësojnë zhvillimin e seancave përmes videokonferencës, duke shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë të fëmijëve me autorët e veprës penale.

✚ Prokuroria e Përgjithshme (PP): Prokuroria e Përgjithshme ka shpërndarë të gjitha prokurorive standardet teknike të hartuara nga Policia e Shtetit për ngritjen e mjediseve të intervistimit miqësor brenda godinave të policisë dhe ka mbajtur komunikime me UNICEF për përfshirjen e praktikave më të mira ndërkombëtare. Në këtë kuadër, prokurorive u janë shpërndarë standardet ISO për trajtimin e fëmijëve viktimë të dhunës, që përkthejnë parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës në standarde të qarta operacionale për modelet e tipit Barnahus/MDIA, duke përfshirë elemente për qeverisjen, stafin, mjediset miqësore, kujdesin ndaj traumës dhe procedurat e intervistimit. Prokuroria e Përgjithshme ka udhëzuar gjithashtu përfshirjen e kërkesave për mjedise të përshtatshme për fëmijët në planet buxhetore të prokurorive të shkallës së parë. Aktualisht, në Prokurorinë e Elbasanit është krijuar një ambient i standardizuar për intervistimin e të miturve, ndërsa deri në ngritjen e ambienteve të posaçme, prokurorët përdorin hapësirat e përshtatura në komisarate. Megjithatë infrastruktura e disa prokurorive paraqet ende probleme, në Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Shkodër dhe Berat janë krijuar kushte bazë për aksesueshmëri, përfshirë rampa dhe ashensorë për personat me aftësi të kufizuara.

✚ Shërbimi i Provës: Gjatë periudhës raportuese, shërbimi i provës ka siguruar përfshirjen e punonjësve të dedikuar për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin në pothuajse të gjitha zyrat vendore. Aktualisht janë në detyrë 35 specialistë të dedikuar në drejtoritë rajonale dhe lokale, ndërsa vetëm dy zyra vendore ende nuk kanë punonjës të specializuar për këtë kategori.


✚ Shërbimi Përmbartimor Shtetëror: Pas ndarjes nga gjykatat, shërbimi përmbartimor ka trashëguar një infrastrukturë të dobët që ka ndikuar në cilësinë e ofrimit të shërbimeve, përfshirë edhe mungesën e ambienteve të përshtatshme për fëmijët. Gjatë periudhës janar–qershor 2025 është bërë e mundur sistemimi i zyrave përmbartimore në Kavajë, Përmet dhe Mat me kushte më të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit. Për zyrën vendore të Tiranës, e cila ka ngarkesën më të lartë të çështjeve, janë zhvilluar kontakte me partnerë ndërkombëtarë për përshtatjen e një ambienti miqësor për fëmijët, projekt që aktualisht ndodhet në proces realizimi.

➤ Objektivi Specifik 3.3

Shërbime mbështetëse të standartizuara, të arritshme për çdo fëmijë.

Plani i Veprimit për Objektivin 3.3 parashikon parashikon 3 masa, prej të cilave 2 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë e pazbatuar.

Objektivi Specifik 3.3: 3 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara

■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- ✚ Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka ndërmarrë masa për forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe konsolidimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijët. Gjatë periudhës raportuese është iniciuar procedura për plotësimin e katër vendeve vakante për përmbartues gjyqësorë shtetërorë, nga të cilat një është plotësuar, ndërsa tre janë në proces rekrutimi. Paralelisht, institucioni ka propozuar shtimin e organikës strukturore për të përballuar ngarkesën në rritje dhe për të përmirësuar shërbimet, duke përfshirë edhe një vlerësim të ndikimit financiar që do të ketë në buxhetin e shërbimit përmbartimor gjyqësor. Me miratimin e kërkesave për shtesë organike, si dhe për sistemim dhe rikonstrukcion ambientesh, pritet të realizohet një rishikim i buxhetit në funksion të përmirësimit të kushteve të punës dhe shërbimeve të ofruara.
- ✚ Në nivel vendor, Bashkia Korçë ka përcaktuar fëmijët si kategori prioritare në Planin e ri të Mbrojtjes Sociale 2024–2027, i cili synon zgjerimin e shërbimeve mbështetëse, përfshirë ato për fëmijët në konflikt me ligjin, duke integruar ndërhyrje të reja për përfshirje sociale dhe mbrojtje efektive.
- ✚ Policia e Shtetit ka garantuar mbulimin me psikologë në të gjitha strukturat e saj, si në nivel qendror ashtu edhe vendor. Psikologët janë pjesë e organikës së Policisë së Shtetit, dhe monitorimi i punës së tyre kryhet nga strukturat përkatëse të Burimeve Njerëzore pa kosto shtesë për buxhetin e institucionit.
- ✚ Prokuroria e Përgjithshme ka raportuar përfshirjen e ekspertëve psikologë në proceset hetimore që përfshijnë të mitur. Sipas të dhënave të mbledhura nga prokuroritë e shkallës së parë, kostot për raportet e vlerësimit të kryera nga psikologë apo ekspertë të jashtëm për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025 janë vlerësuar në rreth 1,697,300 lekë. Për të garantuar transparencë dhe profesionalizëm, listat e ekspertëve të licencuar janë të publikuara si në portalin e Ministrisë së Drejtësisë ashtu edhe pranë vetë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.
- ✚ KLGJ: Gjykatat, në përputhje me legjislacionin në fuqi, referohen po kësaj liste të publikuar nga Ministria e Drejtësisë për caktimin e ekspertëve psikologë në çështjet që përfshijnë fëmijë, duke siguruar standarde të unifikuara për ofrimin e shërbimeve mbështetëse në të gjithë sistemin e drejtësisë.

Sfidat e hasura për realizimin e masave të qëllimit të Politikës III:



- ✚ Kufizime infrastrukturore dhe financiare – Mungesa e ambienteve të përshtatshme dhe fondet e pamjaftueshme për krijimin e mjediseve miqësore për fëmijët në gjykata, prokurori, polici dhe zyra përmbartimore vazhdojnë të ndikojnë në ofrimin e shërbimeve me standardet e kërkuara.
- ✚ Mungesë burimesh njerëzore të specializuara – Nevoja për shtimin e përmbartuesve, psikologëve dhe profesionistëve të trajnuar për të miturit mbetet e lartë, sidomos në strukturat vendore dhe shërbimin e provës.

Qëllimi i Katërt i Politikës

Drejtësi penale që mundëson parandalimin e ripërfshirjes së fëmijës në kryerjen e veprave penale, rishoqërimin dhe ri-integrimin e fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin.

Qëllimi i Katërt i Politikës: 19 masa

19 masa të zbatueshme për JANAR QERSHOR 2025



Plani i Veprimit për Qëllimin e Katërt të Politikës parashikon 19 masa, prej të cilave 10 masa janë zbatuar plotësisht, 9 masa janë zbatuar pjesërisht. 53% e masave janë zbatuar plotësisht.


Plani i Veprimit parashikon 4 (katër) masa për O.S 4.1, 3 (tre) masa për O.S 4.2, 7 (shtatë) masa për O.S 4.3, 3 (tre) masa për O.S 4.4 dhe 2 (dy) masa për O.S 4.5. Masat ndjekin numërimin e planit të veprimit dhe janë me sfond me ngjyrë sipas nivelit të arritjes (*të zbatuara plotësisht/të zbatuara pjesërisht/të pazbatuara*).

➤ Objektivi Specifik 4.1.

Zgjerimi i mundësive të mbikqyrjes së fëmijëve në konflikt me ligjin, përmes shmangies nga ndjekja penale/dënimi.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.1 parashikon parashikon 4 masa, prej të cilave 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 3 masa janë zbatuar pjesërisht. 25% e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 4.1: 4 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar zbatimin e standardeve të drejtësisë penale për të miturit, duke siguruar që të gjitha çështjet që përfshijnë fëmijë në konflikt me ligjin të gjykohen nga gjyqtarë të specializuar. Aktualisht, në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë janë emëruar gjyqtarë të trajnuar posaçërisht për trajtimin e këtyre çështjeve, duke garantuar një proces gjyqësor më të drejtë dhe të ndjeshëm ndaj moshës së të miturve. Ky zhvillim ka sjellë përmirësim të dukshëm në cilësinë e shërbimeve gjyqësore dhe në mënyrën e komunikimit me fëmijët, duke kontribuar në krijimin e një drejtësie më miqësore dhe rehabilituese.
- Prokuroria e Përgjithshme (PP) Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar përpjekjet për forcimin e praktikave të shmangies nga ndjekja penale dhe zbatimin e masave alternative për fëmijët në konflikt me ligjin. Në kuadër të ndërgjegjësimit profesional, në vitin 2021 është përgatitur dhe shpërndarë për të gjitha prokuroritë fletëpalosja për shmangien nga ndjekja penale, e cila mbetet një udhëzues praktik në punën e përditshme të prokurorëve që merren me çështje të të miturve. Dokumenti është gjithashtu i publikuar në faqen zyrtare të institucionit për transparencë të gjerë. Në raportin vjetor 2024, të miratuar në mars 2025, është analizuar në mënyrë të detajuar zbatimi i politikave penale ndaj të miturve dhe efektiviteti i masave alternative, duke nënvizuar rëndësinë e qasjes rehabilituese dhe parandalimit të ripërsëritjes së veprave penale nga fëmijët.


- Bashkia Kamëz Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashkinë Kamëz ka bashkëpunuar ngushtë me Shërbimin e Provës për përgatitjen e raporteve të vlerësimit individual të të miturve në përputhje me nenin 47/9 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Për periudhën janar–qershor 2025, janë trajtuar dy raste konkrete në këtë drejtim, ku njësia ka vënë në dispozicion informacionin social dhe familjar të nevojshëm për të mundësuar vendimmarrje të bazuara në interesin më të lartë të fëmijës.
- Bashkia Durrës Në Bashkinë Durrës, procesi i marrjes së mendimit të Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në rastet që përfshijnë të mitur është tashmë i konsoliduar dhe evidentohet nga institucionet bashkëpunuese në rreth 80% të rasteve. Për më tepër, 70% e punonjësve të kësaj njësie kanë marrë pjesë në trajnime dhe seminare për përmirësimin e praktikave ndërinstitutionale dhe shkëmbimin e eksperiencave mbi qasjet e reja të punës me fëmijët në konflikt me ligjin.
- Bashkia Korçë Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashkinë Korçë ka vijuar të ofrojë mbështetje aktive për fëmijët në konflikt me ligjin, përmes këshillimit, orientimit drejt aktiviteteve edukative dhe përfshirjes në kurse profesionale. Në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, janë përgatitur raporte social-ekonomike për çdo rast, të cilat janë përcjellë pranë prokurorisë për ndjekjen e mëtejshme të procedurave. Ky bashkëpunim synon forcimin e procesit të rivlerësimit dhe riintegritit të fëmijëve në komunitet.
- Instituti i të Miturve Kavajë (IM Kavajë) Instituti i të Miturve në Kavajë ka bashkëpunuar me Shërbimin e Provës për dhënien e informacionit mbi progresin e fëmijëve gjatë vuajtjes së dënimit me burgim, duke mbështetur vlerësimin e efektivitetit të masave të rehabilitimit dhe përgatitjen për riintegrim social pas lirimit. Kjo qasje synon të mbështesë procesin e individualizimit të ndërhyrjeve në përputhje me nevojat psikosociale të çdo të mituri

➤ **Objektivi Specifik 4.2**

Programe të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit të mundësuar për fëmijën në konflikt me ligjin ose viktimë e krimit, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.2 parashikon parashikon 3 masa, 1 masa prej të cilave është zbatuar plotësisht dhe 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe një masë e pazbatuar. **34%** e masave janë zbatuar pjesërisht.

Objektivi Specifik 4.2: 3 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- ✚ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka ndërmarrë hapa konkretë për forcimin e mekanizmave që mbështesin trajtimin e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe viktimave të dhunës. Gjatë muajit maj 2025 është ngritur Grupi i Punës për “Vlerësimin e krijimit të funksionit të dedikuar të specialistit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të miturve”, me qëllim rishikimin e strukturës aktuale policore dhe krijimin e një funksioni të specializuar në çdo komisarjat. Aktualisht, në çdo Drejtori Vendore të Policisë është i emëruar nga një specialist për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të miturve, ndërsa në DVP Tiranë funksionon një Seksion i veçantë me dy specialistë të dedikuar. Megjithatë, në komisarjatet e policisë ende nuk ekzistojnë pozicione të dedikuara për fëmijët, dhe trajtimi i rasteve të të miturve kryhet nga punonjësit e hetimit të krimeve sipas zonave policore.
- ✚ Prokuroria e Përgjithshme (PP) Në funksion të forcimit të drejtësisë restauruese dhe zbatimit të masave alternative për fëmijët, Prokurori i Përgjithshëm në datë 21 janar 2025 miratoi udhëzimin “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 17/2021 ‘Për ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitarë të veprës penale’”. Ky akt ka për qëllim nxitjen e përdorimit të masave të shmangies nga procedimi penal dhe aplikimin e mekanizmave të drejtësisë restauruese. Gjatë periudhës janar–qershor 2025, nga të dhënat statistikore të prokurorive është evidentuar zbatimi i dy masave detyruese ndaj të miturve, ndërsa për 29 të mitur është aplikuar masa e këshillimit si formë shmangie nga ndjekja penale. Prokuroria ka rekomanduar gjithashtu rishikimin e mekanizmave të vlerësimit të pavarur, për të siguruar që këto procese të kryhen në mënyrë të paanshme dhe jashtë strukturave të brendshme.
- ✚ Shërbimi i Provës Shërbimi i Provës ka vijuar me zbatimin praktik të masave detyruese me karakter edukativ e rehabilitues, të cilat synojnë shmangien e burgimit dhe rivendosjen e fëmijëve në procesin arsimor. Konkretisht, gjatë periudhës janar–qershor 2025 janë regjistruar raste të shumta të aplikimit të masës së detyrimit për ndjekjen ose rifillimin e studimeve: një rast në degën Vlorë, dy raste në Shkodër, dy raste në Lushnjë, një rast në Fier, tre raste në Korçë për ndjekjen e studimeve dhe dy raste për rifillimin e tyre. Këto masa konsiderohen efektive në drejtim të parandalimit të ripërfshirjes dhe rritjes së ndërgjegjësimit social të të miturve.
- ✚ Bashkia Kamëz Në Bashkinë Kamëz, për të gjitha rastet e referuara nga institucionet e drejtësisë janë hartuar Planet Individuale të Mbrojtjes (PIM), në përputhje me problematikat e secilit fëmijë. Megjithëse nuk janë raportuar raste të ndërmjetësimit formal gjatë periudhës raportuese, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve ka ofruar këshillim psikosocial për fëmijët dhe familjet e tyre, në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse që veprojnë në territor.
- ✚ Bashkia Korçë Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashkinë Korçë, në rastet ku i kërkohet të shprehet për masat që duhet të merren ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin, rekomandon masa më të lehta, duke marrë parasysh moshën, rrethanat sociale dhe ekonomike të fëmijës. Qasja është përqendruar në parandalimin dhe rehabilitimin përmes këshillimit dhe referimit në programe edukative ose profesionale.
- ✚ Bashkia Durrës Në Bashkinë Durrës, 70% e rasteve janë trajtuar në kuadër të planeve të këshillimit dhe terapive mbështetëse, të ofruara nga psikologët dhe punonjësit socialë të Qendrave Multifunksionale, si dhe nga ekspertët e organizatave partnere. Këto masa kanë synuar përmirësimin e mirëqenies emocionale të fëmijëve dhe ndërtimin e aftësive për riintegrim në shkollë dhe komunitet.
- ✚ Bashkia Vlorë Në Bashkinë Vlorë, Shërbimi Mbështetës për Fëmijët dhe Familjet pranë Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social ka zbatuar plane këshillimi për fëmijët dhe familjet si masë alternative ndaj ndjekjes penale. Janë zhvilluar vizita vlerësuese në familje, ku është ofruar këshillim për pasojat e veprave penale dhe rëndësinë e shmangies së sjelljeve të rrezikshme, duke përfshirë fëmijën dhe prindërit në procesin e rehabilitimit.

➤ Objektivi Specifik 4.3




Struktura mbikëqyrëse që garantojnë trajtimin miqësor, rishoqërizimin, rehabilitimin e fëmijës në konflikt me ligjin.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.3 parashikon parashikon 7 masa, 5 prej të cilave janë zbatuar plotësisht dhe 2 janë zbatuar pjesërisht. **71%** e masave janë zbatuar plotësisht

DRAFT

Objektivi Specifik 4.3: 7 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka vijuar përpjekjet për forcimin e strukturave mbikëqyrëse dhe përmirësimin e kushteve të rehabilitimit të të miturve në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale. Janë finalizuar disa marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi, përfshirë atë ndërmjet DPB dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), nr. 17028, datë 29.10.2024, e cila synon fuqizimin e formimit profesional në burgje, përfshirë edhe të miturit. Po ashtu, është miratuar Udhëzimi i përbashkët ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) për arsimin dhe formimin profesional të të burgosurve, si dhe është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit për ofrimin e arsimit të detyruar dhe të mesëm në Institutin e të Miturve (IM) Kavajë. Për të miturit në IM Kavajë ofrohen programe të ndryshme arsimore dhe profesionale, si kurse në saldime, mobilieri, punime hidraulike, gjuhë të huaj (anglisht) dhe teknologji informacioni. Gjatë periudhës janar-qershor 2025, në këto programe kanë marrë pjesë 52 kursantë, prej të cilëve 13 janë të mitur. Arsimi i detyruar dhe ai i mesëm janë ofruar për të gjithë fëmijët e pranishëm në institucion. Stafi i IM Kavajë është trajnuar nga Caritas Albania mbi përdorimin e manualit për ndërhyrje psikosociale dhe teknikat e prindërimit, në kuadër të projektit të mbështetur nga Qeveria Suedeze dhe ajo Shqiptare për forcimin e kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë për të mitur. Gjithashtu, IM Kavajë zhvillon takime periodike me përfaqësues të institucioneve partnere për zbatimin e masave alternative dhe procesin e riintegrit të të miturve.
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) AKPA ka vijuar zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me DPB për zhvillimin e kurseve profesionale në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Udhëzimi i përbashkët ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe MEKI për mënyrën e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional është nënshkruar nga MD dhe është në pritje të firmosjes nga MEKI. Agjencia, në bashkëpunim me DPB, ka përcaktuar kriteret për përfshirjen e të miturve në kurse profesionale në përputhje me moshën dhe nivelin arsimor, me synim përgatitjen për tregun e punës pas lirim.
- Qendra për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) Në kuadër të riintegrit të të miturve pas përfundimit të dënimit, QPKMR ka nënshkruar në janar

2025 marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale të AKPA Tiranë për përfshirjen e të miturve në programe punësimi dhe formimi profesional. Qendra ka vijuar ndjekjen e ecursisë së rasteve të suksesshme të të miturve të liruar nga IM Kavajë, duke mundësuar ndjekjen e kurseve profesionale në berber dhe gjuhë të huaj për disa prej tyre. Gjatë periudhës janar–qershor 2025, QPKMR ka zhvilluar 20 takime me institucione të sistemit të drejtësisë dhe 10 takime me përfaqësues të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në qytetet kryesore të vendit. Bashkëpunimi ka qenë efektiv në trajtimin e rasteve sipas detyrimeve ligjore dhe në garantimin e një qasjeje të koordinuar ndërinstitutionale për riintegrimin e fëmijëve në shoqëri.


- ✚ Shërbimi i Provës (SHP) Shërbimi i Provës ka vijuar monitorimin e rasteve të të miturve të liruar dhe bashkëpunimin me DPB për hartimin e raporteve të vlerësimit individual. Takime periodike zhvillohen për koordinimin e zbatimit të masave alternative ndaj dënimit me burgim. Struktura e monitorimit ka evidentuar disa mungesa infrastrukturore në degët territoriale, por Ministria e Drejtësisë ka në vëmendje sigurimin e ambienteve të përshtatshme për një shërbim efikas dhe miqësor ndaj të miturve.
- ✚ Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) Në kuadër të përmirësimit të koordinimit ndërinstitutional, SHSSH ka përditësuar “Hartën e Shërbimeve Sociale” në bashkëpunim me PNUD, duke identifikuar ofruesit publikë dhe jopublikë të shërbimeve për kategoritë në nevojë, përfshirë fëmijët në konflikt me ligjin. Harta është publikuar në faqen zyrtare të institucionit dhe synon të lehtësojë referimin dhe qasjen në programe mbështetëse, ndërsa po punohet për krijimin e versionit dixhital të saj.
- ✚ Bashkia Kamëz Në datën 14 prill 2025, Bashkia Kamëz zhvilloi një takim të përbashkët me QPKMR-në, Caritas Albania dhe përfaqësues të Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, ku u diskutuan rastet e suksesshme të riintegritit dhe sfidat në proces. Bashkia, në bashkëpunim me organizatat partnere, ofron këshillim psikologjik, kurse profesionale dhe ndihmë sociale për fëmijët e liruar nga IM Kavajë, duke i orientuar drejt programeve rehabilituese.
- ✚ Bashkia Korçë Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashkinë Korçë ka vijuar bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse si Zyrat e Punësimit, Drejtorinë Arsimore, Zyrën e Formimit Profesional dhe OJF-të për të mundësuar riintegrimin e fëmijëve në konflikt me ligjin. Pasi realizohet vlerësimi fillestar, hartohet Plani Individual i Mbrojtjes (PIM) dhe çdo institucion përfshihet në zbatimin e tij. Megjithatë, efektiviteti i planeve të rehabilitimit është i kufizuar nga faktorë si varfëria, mungesa e arsimit dhe problemet social-ekonomike të familjeve.
- ✚ Bashkia Durrës Në bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve, Bashkia Durrës ka realizuar takime dhe vizita në shtëpi për të miturit në proces rehabilitimi. Për rastet e referuara, janë ofruar shërbime sociale dhe mbështetje psikosociale, si dhe orientim drejt programeve të punësimit dhe arsimit, duke arritur një nivel zbatimi rreth 80%.
- ✚ Bashkia Lushnjë ka trajtuar 20 raste të të rinjve në konflikt me ligjin gjatë periudhës janar–qershor 2025 në bashkëpunim me Zyrën e Shërbimit të Provës. Janë ofruar masa alternative për parandalimin e ripërfshirjes në kriminalitet, përmes këshillimit psikologjik, përfshirjes në aktivitete rinore dhe ndjekjes së arsimit. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve ka bashkëpunuar me Zyrën e Shërbimit Ligjor Falas për ofrimin e këshillimit dhe asistencës juridike për të miturit.

➤ Objektivi Specifik 4.4

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka kapacitetet e duhura në fushën e parandalimit të ripërfshirjes së të miturit në kryerjen e veprave penale.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.3 parashikon parashikon 3 masa, 1 prej të cilave zbatuar plotësisht dhe 1 është zbatuar pjesërisht dhe 1 masë e pazbatuar. **34%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 4.4: 3 masa



■ Plotësisht të zbatuara ■ Pjesërisht të zbatuara
■ Të pazbatuara

Arritjet kryesore për periudhën raportuese:


- Qendra për Parandalimin e Krimeve të Miturve dhe të Rinjve ka marrë pjesë në trajnime të specializuara të organizuara nga UNICEF, OSBE dhe partnerë të tjerë, me fokus parandalimin e kriminalitetit tek të rinjtë dhe sfidat në menaxhimin e rasteve të miturve. Qendra ka vijuar ndjekjen e rasteve të suksesshme të miturve të liruar nga IM Kavajë, duke mundësuar për ta përfshirje në kurse profesionale dhe mbështetje për riintegrim. Nga fëmijët që kanë përfunduar dënimin, një pjesë kanë ndjekur me mbështetjen e QPKMR kurse profesionale, si dhe janë bërë përpjekje për ruajtjen e kontakteve dhe mbikëqyrjen pas lirit. Paralelisht, QPKMR ka vijuar rolin e saj si administrator i Sistemit të Integruar të Dhënave për Drejtësinë Penale për të Mitur, duke monitoruar popullimin e tij nga institucionet përkatëse. Pas një periudhe mosfunksionimi (tetor 2024–prill 2025), sistemi është rivendur në punë më 14 prill 2025, janë intensifikuar komunikimet me institucionet përdoruese dhe i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë raporti gjashtëmuor mbi funksionimin e tij. Megjithatë, Qendra nuk ka arritur ende të marrë përsipër hartimin dhe miratimin e kurrikulave të trajnimit, për shkak të kufizimeve ligjore dhe kapaciteteve aktuale, duke parashikuar që kjo detyrë të trajtohet në mënyrë të plotë vetëm me ngritjen e Institutit të posaçëm dhe zgjerimin e stafit.
- Bashkia Vlorë: Shërbimi social i Bashkisë Vlorë, në bashkëpunim me Policinë, Prokurorinë, Shërbimin e Provës dhe familjet, ka vijuar të ofrojë mbështetje të strukturuar për fëmijët në konflikt me ligjin. Janë kryer vlerësime socio-ekonomike në familje, është siguruar përfaqësimi i fëmijëve në procedurat gjyqësore dhe pranë Shërbimit të Provës, janë ndërmjetësuar lidhjet me Zyrën Arsimore për vijimin e shkollës, si dhe janë ofruar monitorim dhe këshillim psikosocial për të reduktuar rrezikun e ripërfshirjes në vepra penale. Këto ndërhyrje janë zhvilluar në koordinim me mekanizmat lokalë të mbrojtjes së fëmijëve dhe programet e riintegrit.
- Prokuroria e Përgjithshme: Koordinatorët pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm kanë vijuar hedhjen dhe përditësimin e të dhënave në Sistemin e Integruar të Drejtësisë Penale për të Mitur, në bashkëpunim me QPKMR. Ky proces synon garantimin e monitorimit të vazhdueshëm të trajtimit të miturve në sistemin penal dhe lehtësimin e analizës për politikën parandaluese dhe masat rehabilituese.

➤ Objektivi Specifik 4.5

Fuqizimi i rrjetit të bashkëpunimit ndërinstitucional të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijën.

Plani i Veprimit për Objektivin 4.4 parashikon parashikon 2 masa, 1 prej të cilave është zbatuar plotësisht dhe 1 është zbatuar pjesërisht. **50%** e masave janë zbatuar plotësisht.

Objektivi Specifik 4.5: 2 masa



Arritjet kryesore për periudhën raportuese:

- Qendra për Parandalimin e Krimeve të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) Në zbatim të planit të aktiviteteve, QPKMR ka vijuar përpjekjet për forcimin e rrjetit ndërinstitucional të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët. Në bashkëpunim me Caritas Albania, janë zhvilluar takime me rrjetet ndërsektoriale në bashkitë kryesore të vendit — Korçë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë — me qëllim vlerësimin e funksionimit të tyre, evidentimin e boshllëqeve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendore që trajtojnë raste të miturve në konflikt ose kontakt me ligjin. Në përfundim të këtyre takimeve, QPKMR ka parashikuar hartimin e një Memorandumi të Bashkëpunimit Ndërinstitucional, që do të nënshkruhet nga institucionet kryesore në nivel vendor, për të formalizuar mekanizmat e bashkërendimit dhe ndarjen e qartë të përgjegjësisë. Paralelisht, Qendra ka zhvilluar dhjetë takime të dedikuara me punonjës të mbrojtjes së fëmijëve dhe aktorë të tjerë lokalë për trajtimin e rasteve të miturve nën mbikëqyrje, duke kontribuar në konsolidimin e rrjeteve të referimit dhe përmirësimin e ndërveprimit praktik mes institucioneve.
- Shërbimi i Provës (SHP) Shërbimi i Provës ka luajtur një rol aktiv në bashkëpunimin ndërinstitucional, duke realizuar hartimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, me synim forcimin e koordinimit në rastet që përfshijnë fëmijët dhe të rinjtë në proceset e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe masave alternative. Marrëveshja përcakton detyrime të ndërsjella për shkëmbimin e informacionit, mbështetjen psikosociale dhe ndjekjen e rasteve pas vendimit penal.


- Bashkia Korçë Bashkia Korçë ka ndërtuar një sistem bashkëpunimi ndërsektorial funksional, përmes Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN), në të cilin marrin pjesë përfaqësues nga të gjitha institucionet vendore relevante, si Policia, Prokuroria, Shërbimi Social, Drejtoria Arsimore dhe organizatat jofitimprurëse. Ky grup mbledhet sa herë është e nevojshme për të adresuar raste të fëmijëve dhe të miturve në rrezik apo në konflikt me ligjin, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe ndarjen e përgjegjësiave për secilin institucion. Çdo aktor raporton periodikisht tek Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve për ecurinë e rasteve dhe për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes.
- Bashkia Lushnjë Në Bashkinë Lushnjë, bashkëpunimi ndërmjet Zyrës së Shërbimit të Provës, Policisë, Prokurorisë dhe Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve ka sjellë rezultate të prekshme në trajtimin e 20 rasteve të rinjve në konflikt me ligjin gjatë periudhës janar–qershor 2025. Përmes këtij bashkëpunimi është bërë e mundur mbajtja e fëmijëve larg ripërfshirjes në kriminalitet, forcimi i masave alternative dhe orientimi drejt arsimit, këshillimit dhe rehabilitimit. Bashkia ka forcuar mekanizmat e bashkërendimit për të garantuar që çdo i mitur të ketë akses në një sistem të drejtësisë miqësore, që mundëson rivendosjen e të drejtave të tij në fushën penale, civile dhe administrative.

Sfidat e hasura për realizimin e masave të qëllimit të Politikës IV:

- Mungesa e burimeve njerëzore të specializuara dhe infrastrukturës së përshtatshme në institucionet që punojnë me të miturit.
- Koordinim ende i pjesshëm dhe jo i standardizuar ndërmjet institucioneve që trajtojnë rastet e fëmijëve.
- Mungesë programesh të unifikuara për drejtësinë restauruese, rehabilitimin dhe riintegrimin.

NIVELI I REALIZIMIT NË TOTAL PËR 64 MASA NË PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

Niveli i realizimit në total për 64 masa:



Plani i Veprimit, për periudhën janar-qershor 2025, parashikon 64 masa në të cilat institucionet përgjegjëse raportojnë progresin përfshirë masat të cilat raportohen rregullisht dhe masat të cilat fillojnë zbatimin e tyre gjatë vitit 2024. Gjatë periudhës raportuese, 47% e masave janë zbatuar plotësisht, 51% e masave janë zbatuar pjesërisht dhe 2% e masave janë të pazbatuara.

➤ Vlerësimi i sfidave, hapat në vijim

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën raportuese, konstatohet se institucionet kanë treguar një performancë të mirë në zbatimin e masave, megjithatë vijnë të evidentohen aktivitete të parealizuara, të pazbatuara ose të paraportuara. Në analizën e performancës rezulton se mungesa e burimeve njerëzore të specializuara dhe kapaciteteve institucionale, si dhe mungesa e buxheteve të dedikuara për realizimin e disa veprimtarive të planifikuara, kanë ndikuar në mosarritjen e plotë të objektivave për periudhën përkatëse.

Në funksion të përmirësimit të zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2023–2024, sfidat dhe prioritetet për periudhat e ardhshme përfshijnë:

- Sigurimin që informacioni i raportuar të jetë faktik, i mbështetur në evidenca të qarta dhe të dhëna analitike, në përputhje me masat e caktuara për zbatim.
- Lidhjen e çdo qëllimi politik me nivelin real të zbatueshmërisë dhe me buxhetin e planifikuar dhe atë faktik të përdorur.
- Rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse për rëndësinë e zbatimit në kohë dhe cilësor të Planit të Veprimit, si dhe për rolin e procesit të raportimit.
- Fuqizimin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies institucionale përmes koordinimit të brendshëm dhe ndërinstitutional.
- Rakordimin e informacionit të raportuar me drejtoritë e financës përkatëse përpara dërgimit përfundimtar të të dhënave.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi rekomandohet që:

- ✚ Të vijojë zbatimi i masave në statusin “zbatuar pjesërisht/në proces” sipas afateve të parashikuara;
- ✚ Të nisë zbatimi në kohë i masave/aktiviteteve të parashikuara për periudhën në vijim;
- ✚ Të sigurohet operativiteti i burimeve dhe kapaciteteve njerëzore dhe ekspertizës së nevojshme për kryerjen e tyre;
- ✚ Dërgimi i informacionit mbi disbursimin financiar për aktivitetet e parashikuara në strategji, pasi ndikojnë në pasqyrimin jo real të kostove për zbatimin e Strategjisë;
- ✚ Të sigurohet bashkëpunimi institucional i nevojshëm për masa e aktivitete të përbashkëta;



DRAFT